



www.qbz.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2018 – Numri: 28

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E hënë, 16 korrik 2018

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit nr. 3, datë 22.6.2018	Mbi kërkesën e depozituar nga Këshilli Drejtues i Sportelit Unik - SUADA, për administrimin e së drejtës së autorit, në datën 25.5.2018...	3
Kërkesë e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit nr. 3436, datë 6.7.2018	Për botim të vendimeve për dënim administrativ, për subjektet: 1. Spitali Obstetrik-Gjinekologjik “Koço Gliozheni”, nr. 5, datë 7.3.2017; 2. “Korsel” sh.p.k., nr. 4, datë 21.10.2016; 3. Leonard Balika, nr. 2, datë 13.2.2017.....	5
Njoftim i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 5139/2, datë 9.7.2018	Për pozicionin e lirë të Sekretarit të Përgjithshëm në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.....	9
Njoftim i Institucionit të Presidentit të Republikës nr. 2023, datë 13.7.2018	Për shpalljen e vendeve vakante pranë Institucionit të Komisionerit Publik.....	9
Njoftim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 554, datë 13.7.2018	Për shitje me ankand të pronës shtetërore në administrim të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.....	10

**VENDIM****Nr. 3, datë 22.6.2018****MBI KËRKESËN E DEPOZITUAR NGA
KËSHILLI DREJTUES I SPORTELIT
UNIK - SUADA, PËR ADMINISTRIMIN E
SË DREJTËS SË AUTORIT,
NË DATËN 25.5.2018****Këshilli Kombëtar i së Drejtës së Autorit, i
përbërë nga:**

Znj. Ines Muçostepa: kryetare;

Znj. Ekflodia Leskaj: anëtare;

Z. Plarent Ndreca: anëtar;

Z. Ilirjan Celibashi: anëtar;

Z. Arben Papadhopulli: anëtar.

Sekretariati Teknik, i përbërë nga:

Znj. Ledina Beqiraj;

Znj. Sonila Meka;

Znj. Dardana Grabovaj.

KËRKUES: Agjencia Albautor, AAK për të drejtën e autorit, Kryetar i Këshillit Mbikëqyrës i Sportelit Unik - SUADA; Agjencia FMAA, AAK për të drejtën e autorit të veprave kinematografike dhe audiovizive, anëtar i Këshillit Mbikëqyrës; Agjencia AKDIE, AAK për të drejtën e artisteve interpretues/ekzekutues, anëtar i Këshillit Mbikëqyrës;

Drejtori Ekzekutiv i Sportelit Unik - SUADA, z. Zamir Sukniqi.

OBJEKTI: 1. Marrjen e masës së pezullimit të transfertave dalëse të llogarisë bankare të SUADA-s, për shkak të konfliktit të Këshillit Mbikëqyrës – SUADA – drejtor ekzekutiv i SUADA-s, deri në ndryshimet e domosdoshme statutores, me qëllim zgjedhjen e drejtorit të ri ekzekutiv;

2. Vënie në lëvizje të KKDA-së për shfuqizimin e vendimit nr. 4, datë 10.10.2017, për shkak të problematikës së konstatuar në konfliktin: Këshill Mbikëqyrës – drejtor ekzekutiv i SUADA-s, në rast të mosbindjes së ish-drejtorit, z. Sukniqi, për të zbatuar me korrektesë vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të SUADA-s.

BAZA LIGJORE: Ligji nr. 35/2016, datë 31.3.2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”; ligji nr. 8788, “Për organizatat jofitimprurëse”; udhëzimi nr. 663 datë 10.10.2017, “Për mënyrën e funksionimit dhe të organizimit të Sportelit Unik për

administrimin e së drejtës së autorit – SUADA, në administrimin kolektiv”; vendimi i KKDA-së nr. 4 datë 10.10.2017 i Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit, “Për transferimin e funksionit kolektiv të mbledhjes së tarifave të shpërblimit për të gjitha kategoritë e mbajtësve të të drejtave të autorit dhe të të drejtave të tjera të lidhura me to, drejt njëres prej agjencive të administrimit kolektiv dhe për drejtimin e Sportelit Unik për administrimin e së drejtës së autorit - SUADA”.

KKDA konstatoi se çështja është në kompetencë të tij për shqyrtimin e kërkesës së depozituar nga pala kërkuuese, si dhe vijoi më tej,

VËREN:

Se kërkuesi i është drejtuar organit kolegjal KKDA, me anë të kërkesës së depozituar në Ministrinë e Kulturës, datë 25.5.2018, dhe ka kërkuar njohjen e vendimit të Këshillit Mbikëqyrës të SUADA-s, datë 18.5.2018, nga ana e ish-drejtorit ekzekutiv të SUADA-s, z. Sukniqi.

Nga shqyrtimi i dokumentacioneve të depozituara në Ministrinë e Kulturës, si dhe vënien në dispozicion të KKDA-së, rezultoi se:

Pala kërkuuese, konkretisht, Këshilli Mbikëqyrës i Sportelit Unik SUADA, ngre pretendimet e mëposhtme:

- Nga data 9 janar 2018 dhe deri në datën 18 maj 2018, me mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës, rezultoi se në llogarinë bankare të SUADA-s, prurjet janë shumë më të ulëta, se çfarë AAK-të, në zhvillimin e tyre individual kanë pasur në këtë periudhë të vitit dhe fakti rezultoi se është kaluar kufiri “i kuq” i tavanit prej 30% të shpenzimeve SUADA + AAK, të përcaktuar në udhëzimin e ministrit.

- Tjetër fakt është se subjekteve nuk u është kërkuar lista e veprave të përdorura dhe kjo është domosdoshmëri për shpërndarjen monetare nga ana e AAK-së për titullarin individual.

- Është rekrutuar një numër i madh punonjësish pa asnjë kriter profesional dhe, në disa raste, në kushte të qarta të konfliktit të interesit për shkak të lidhjeve farefisnore/krushqi, duke rritur ndjeshëm kostot e SUADA-s, si dhe me një performancë tejet të dobët. Janë 2 punonjës për Gjykostrën dhe 2 punonjës për Korçën, por që në fakt kanë 0 arkëtime.



- Situata e konfliktit të interesit e provuar qartë midis Zamir Sukniqit, drejtues i SUADA-s, Drejtues i AMP-së dhe ortak me 50% i “Albatrade Plus” sh.p.k.

- Braktisje e detyrës për periudha të gjata dhe të herëpashershme për udhëtime pune jashtë vendit dhe ndërkohë nuk ka asnjë autorizim apo leje nga Këshilli Mbikëqyrës për të përfaqësuar SUADA-n në asnjë organizëm ndërkombëtar.

- Një tjetër shkelje e rëndë e provuar me *email*, sipas z. Puto, është kontaktimi i shoqërive simotra nga ana e z. Sukniqi, për t'i pyetur mbi të ardhurat që këto shoqëri duhet të derdhen në llogarinë e Albautor (provuar me *email* bashkëlidhur).

- Paaftësi e z. Sukniqi për të konkluduar marrëveshjet e bashkëpunimit midis SUADA-s dhe institucioneve ligjzbatuese, ku draftet janë përgatitur nga AKDIE-ja.

- Nuk ka firmosur asnjë marrëveshje me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve lidhur me proformen dhe pozitën e saj si agjente TVSH-je;

- Në periudhën shkurt–prill, z. Zamir Sukniqi ka kryer tërheqje të vazhdueshme nga llogaria e SUADA-s, në vlerën 336 000 lekë dhe rezultojnë pa asnjë dokument shoqërues tërheqjeje në vlerën 247 117 lekë.

- Ka blerë 2 200 litra naftë për tre muaj (1600 litra janë konsumuara dhe 600 janë gjendje).

- Z. Sukniqi i ka vënë vetes një pagë mujore prej 100 000 lekësh pa asnjë miratim nga Këshilli Mbikëqyrës i SUADA-s, si dhe në kundërshtim me ligjin për OJF-të, ku punonjësi i paguar nuk mund të jetë anëtar i organit vendimmarrës të organizatës jofitimprurëse.

- Në datën 21.2.2018 është kryer pagesa prej 10 000 mijë eurosh për blerjen e tri makinave të SUADA-s, faturë parapagim, e cila është një borxh për SUADA-n.

- Shpenzime: filtra makinash, bateri, goma, shpenzime për servis makinash, të cilat sipas raportimit janë makina të vjetra të z. Sukniqi dhe në pronësi të AMP-së, por që riparohen me fondet e SUADA-s.

- Ka faturuar “NEPTUN” sh.p.k., me vlerën prej 105 600, ndërkohë që sipas sistemit tarifar është vlera 588 960 lekë. Mos vallë kjo vlerë 5 herë më e vogël është se në ambientet e NEPTUN-it ndodhen pikat e shitjes së subjektit “Albatrade Plus”?

- Rezulton i kontraktuar nga SUADA, si monitorues i qarkut Korçë, z. Kristi Bello, por njëkohësisht është i punësuar dhe në një subjekt prodhimesh fonografike “ON OF Production”, me administrator z. Arben Skenderi dhe, për këtë arsye mungon në fotoalbumin e SUADA-s, ku monitoronin Korçën (prova bashkëngjitur).

- Mënyra e dokumentimit të aktivitetit financiar ku përdoren fatura të thjeshta tatimore, të cilat lënë vend për abuzim në vend të dokumentacionit të duhur ligjor, që janë blerje që kryhen me fatura tatimore me TVSH, të cilat për më tepër do të ishin TVSH e zbritshme dhe logjikisht më shumë vlera të mbetura për llogari të SUADA-s dhe AAK-ve.

Sa më sipër, KKDA-ja dëgjoi palën kërkuese, mbi të gjitha pretendimet e parashtruara më lart.

Z. Sukniqi, si drejtor ekzekutiv i SUADA-s parashtroi pretendimet, si më poshtë vijon:

- Nuk kam dijeni mbi vendimin që Këshilli Mbikëqyrës ka marrë në datën 18.5.2018, pasi nuk kam qenë i pranishëm. Për arsye pune kam qenë në Republikën Popullore të Kinës.

- Agjencitë e Administrimit Kolektiv momentalisht janë pa licenca dhe bazuar udhëzimit të ministrit, anëtar të agjencisë janë kryetarët e agjencive të licencuara ndaj vendimi i tyre është nul.

- Nuk kanë zbatuar afatin e thirrjes për mbledhjen e radhës, bazuar statutit të SUADA-s.

- Nuk kam dijeni për shkeljet apo abuzimet që anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës pretendojnë.

- Shpërndarja për tek agjencitë e administrimit kolektiv nuk është kryer pasi momentalisht këto agjenci janë pa licenca.

Gjithashtu, z. Sukniqi ngre pretendimet, se:

Në asnjë moment nuk kam shkelur ligjin për të drejtën e autorit, si dhe udhëzimin e ministrit, por deri më tani kam arritur me sukses në të gjithë hapat që kam ndërmarrë.

Kam monitoruar/inspektuar pothuajse të gjithë territorin e RSH-së, si kurrë më parë, duke prerë kështu proforma të cilat kapin vlera kolosale.

Për mbarëvajtjen e Sportelit Unik, kam krijuar një platformë në *Google* e cila është e lidhur drejtpërdrejt me satelitin dhe bën të mundur kështu identifikimin e adresave të subjektit, si dhe metrat katrorë për secilin subjekt. Kjo bën të mundur që SUADA të evidentojë saktë përmasat



që ka subjekti, pasi bazuar përmasave dhe shumë elementeve të tjera subjektit i caktohet vlera që duhet të paguajë. Së fundmi, në emër të SUADA-s kam lidhur 2 marrëveshje/kontratë të cilat lehtësojnë urdhërojnë subjektin përdorues të paguajë detyrimin e saj.

Në konstatim të të gjitha pretendimeve, si dhe provave bashkëlidhur, bazuar ligjit nr. 35/2016, datë 31.3.2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”; ligjit nr. 8788, “Për organizatat jofitimprurëse”; udhëzimit nr. 663, datë 10.10.2017, “Për mënyrën e funksionimit dhe të organizimit të Sportelit Unik për administrimin e së drejtës së autorit – SUADA, në administrimin kolektiv”; vendimit të KKDA-së nr. 4, datë 10.10.2017, të Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit, “Për transferimin e funksionit kolektiv të mbledhjes së tarifave të shpërblimit për të gjitha kategoritë e mbajtësve të të drejtave të autorit dhe të të drejtave të tjera të lidhura me to, drejt njëres prej agjencive të administrimit kolektiv dhe për drejtimin e sportelit unik për administrimin e së drejtës së autorit – SUADA”.

Në këto kushte:

KËSHILLI KOMBËTAR PËR TË DREJTËN E AUTORIT

VENDOSI:

1. Pranimin e pjesshëm të kërkesës së palës kërkuuese, mbi:

a) Ndryshimin e vendimit me nr. 4, datë 10.10.2017 të KKDA-së, duke i hequr të drejtën e drejtimit të SUADA-s, Agjencisë së Administrimit Kolektiv, AMP.

b) Miratimin e vendimit të Këshillit Mbikëqyrës të SUADA-s, për shkarkimin e z. Zamir Sukniqi, si drejtor Ekzekutiv i Sportelit Unik.

c) Emërimin e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës të SUADA-s, z. Puto, si drejtor ekzekutiv i përkohshëm, deri në rikostituimin e Këshillit Mbikëqyrës të SUADA-s dhe përfundimit të procedurave të zgjedhjes së drejtorit të ri ekzekutiv të SUADA-s.

2. Rrëzimin e pjesës tjetër të kërkesës së palës kërkuuese, për:

a) Marrjen e masës së pezullimit të transfertave dalëse të llogarisë bankare të

SUADA-s, për shkak të konfliktit të Këshillit Mbikëqyrës SUADA – drejtor ekzekutiv i SUADA-s, deri në ndryshimet e domosdoshme statutore, me qëllim zgjedhjen e një drejtori të ri ekzekutiv.

Kundër këtij vendimi të KKDA-së, palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative kompetente, brenda afateve të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative. Afati i ankimit llogaritet nga data komunikimit të këtij vendimi, palëve në këtë proces.

Sekretar i KKDA-së

Ledina Beqiraj

KKDA

Znj Ines Muçostepa

Znj. Ekflodia Leskaj

Z. Plarent Ndreca

Z. Ilir Celibashi

Z. Arben Papadhopulli

NJOFTIM

Nr. 3436, datë 6.7.2018

PËR BOTIM TË VENDIMEVE PËR DËNIM ADMINISTRATIV, PËR SUBJEKTET: 1. SPITALI OBSTETRIK-GJINEKOLOGJIK “KOÇO GLIOZHENI”, NR. 5, DATË 7.3.2017; 2. “KORSEL” SHPK, NR. 4, DATË 21.10.2016; 3. LEONARD BALIKA, NR. 2, DATË 13.2.2017

Inspektorati Shtetëror i Mjedisit Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Qendër, megjithëse ka realizuar njoftimin zyrtar për vendimin administrativ, nëpërmjet shërbimit postar është kthyer njoftimi i institucionit tonë, duke u konfirmuar nga shërbimi postar, largimi i i subjektit nga ajo adresë apo adresë jo e saktë.

Sa më sipër, Inspektorati i Mjedisit Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Qendër, bën njoftimin publik të vendimeve për dënim administrativ, respektivisht për subjektet si më poshtë:

1. Spitali Obstetrik-Gjinekologjik “Koço Gliozheni”, nr. 5, datë 7.3.2017;

2. “Korsel” sh.p.k., nr. 4, datë 21.10.2016;

3. Leonard Balika, nr. 2, datë 13.2.2017.

KRYEINSPEKTOR I KOMANDUAR
NË DETYRË
Armando Lamaj




 Enrregjistruar
 dhe origjinalin
 Datë 06.07.2018

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E MJEDISIT
 INSPEKTORIATI SHTETËROR I MJEDISIT DHE PYJEVE

VENDIM
PËR
DËNIM ADMINISTRATIV
 Nr. 5, datë 07.03.2017

Nr. Serie: 0003575
 QENDRA E BOTIMEVE ZYRTARE
 Nr. 999/3 prot.
 Datë 09.07.2018

Inspektorët e ISHMP-së, pas ushtrimit të kontrollit mbi veprimtarinë e personit fizik/juridik, "Spitaci Universitare Obstetrik-Gynjekologjike KOGA Glozheni", në mbështetje të nenit 48 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" dhe në zbatim të pikës 19 ii, të nenit 29, të Ligjit nr. 10448, datë 14.07.2014, "Per Lejdet e mjedisit", referuar shkeljeve të pasqyruara në Proces - Verbalin e Konstatimit të Kundërvajtjeve Administrative me Nr. Serie 000 2980, datë 07/03 / 2017, të cilat përbëjnë kundërvajtje administrative:

VENDOSA:

1. Të dënojmë me Gjobë në vlerën : 500.000..... lekë (pesqind mijë Çekë.....)
2. Të dënojmë "Paralajmërim", si dënim administrativ kryesor.
 Si dhe një ose disa nga dënimet plotësuese të mëposhtme:
3. Të pezullojë pjesërisht ose plotësisht aktivitetin:
4. Të sekuestrojë pajisjet, mjetet dhe lëndët e mëposhtme:
5. Të propozojë pezullimin apo revokimin e lejes
6. Të korrigjojë shkeljet e konstatuara dhe t'i raportojë strukturës urdhëruese brenda datës

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim te Komisioni i Ankimit të ISHMP, brenda 10 ditëve nga njoftimi i tij. Gjyba të derdhet në çdo bankë që ka llogari të Thesarit për Ministrinë e Mjedisit, brenda afatit ligjor. Një kopje e mandat - pagesës i dorëzohet Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve. Me kalimin e afateve ligjore ekzekutimi i vendimit të dënimit me gjobë do të bëhet në mënyrë të detyrueshme, në zbatim të Ligjit Nr. 10297, datë 20.05.2010, "Për kundërvajtjet administrative".

Inspektori i ISHMP
X. Haxhiu
Hamid Tahiri
ILIR BARANI
 (Emër, inibimër, firmë)

Mora një kopje të vendimit, sot më datë
 (.....)

Në respektim të procedurave ligjore të përcaktuara në Proces-Verbalin për KKA, vendimi mbahet në katër kopje.



Kopje e njehtuar
me origjinalin
Date 06.07.2018

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E MJEDISIT
 INSPEKTORIATI SHTETËROR I MJEDISIT DHE PYJEVE

Nr. Serie: 0000064

VENDIM
PËR
DËNIM ADMINISTRATIV
 Nr. 04, datë 21.10.2016.

DENDRA E BOTIMEVE ZYRTARE
 Nr. 943 / Prot.
 Datë 09.07.2018

Inspektorët e ISHMP-së, pas ushtrimit të kontrollit mbi veprimtarinë e personit fizik/juridik, "KORSEL Sh.p.k", në mbështetje të nenit 48 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" dhe në zbatim të pikës 1.6, të nenit 48, të Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", referuar shkeljeve të pasqyruara në Proces - Verbalin e Konstatimit të Kundërvajtjeve Administrative me Nr. Serie 0001285, datë 21/10/2016, të cilat përbëjnë kundërvajtje administrative:

VENDOSA:

1. Të dënohet me Gjobë në vlerën : ...100.000... lekë (.....njëqind mijë)
2. Të dënohet me "Paralajmërim", si dënim administrativ kryesor.
Si dhe një ose disa nga dënimet plotësuese të mëposhtme:
3. Të pezullojë pjesërisht ose plotësisht aktivitetin:
4. Të sekuestrojë pajisjet, mjetet dhe lëndët e mëposhtme:
5. Të propozojë pezullimin apo rëvokimin e lejes
6. Të korrigjojë shkeljet e konstatuara dhe t'i raportojë strukturës urdhëruese brenda datës

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankimi te Komisioni i Ankimit të ISHMP, brenda 10 ditëve nga njoftimi i tij. Gjyba të derdhet në çdo bankë që ka llogari të Thesarit për Ministrinë e Mjedisit, brenda afatit ligjor. Një kopje e mandat - pagesës i dorëzohet Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve. Me kalimin e afateve ligjore ekzekutimi i vendimit të dënimit me gjobë do të bëhet në mënyrë të detyrueshme, në zbatim të Ligjit Nr. 10297, datë 20.05.2010, "Për kundërvajtjet administrative".

Mora një kopje të vendimit, sot më datë
(.....)

Inspektori i ISHMP
 Edvin Bica
 Xhendet Haxhia

(Emër, mbiemër, firmë)

Në respektim të procedurave ligjore të përcaktuara në Proces-Verbalin për KKA, vendimi mbahet në katër kopje.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT

INSPEKTORIATI SHTETËROR I MJEDISIT DHE PYJEVE

Kopje e njëhësuar
me origjinalin
datë 06.07.18

Nr. Serie: 0003467

VENDIM

PËR

DËNIM ADMINISTRATIV

Nr. 2, datë 13.02.2017

QENDRA E BOTIMEVE ZYRTARE
Nr. 949/2 Prot.
Datë 09.07.2018

Inspektorët e ISHMP-së, pas ushtrimit të kontrollit mbi veprimtarinë e personit fizik/juridik, "Leonard Balika me Nipz 152108216P", në mbështetje të nenit 48 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" dhe në zbatim të pikës 29, të nenit 62, të Ligjit nr. 10463 datë 22.08.2014 "Për Menaxhimin e Integritetit të Mbetjeve", referuar shkeljeve të pasqyruara në Proces - Verbalin e Konstatimit të Kundërvajtjeve Administrative me Nr. Serie 202567, datë 13.02.2017, të cilat përbëjnë kundërvajtje administrative:

VENDOSA:

1. Të dënohet me Gjobë në vlerën : 1.000.000... lekë (një milion)
2. Të dënohet me "Paralajmërim", si dënim administrativ kryesor.
Si dhe një ose disa nga dënimet plotësuese të mëposhtme:
3. Të pezullojë pjesërisht ose plotësisht aktivitetin: Deri në largimin e pjesëve metalike
4. Të sekuestrojë pajisjet, mjetet dhe lëndët e mëposhtme:
5. Të propozojë pezullimin apo revokimin e lejes
6. Të korrigjojë shkeljet e konstatuara dhe t'i raportojë strukturës urdhëruese brenda datës

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankimi te Komisioni i Ankimit të ISHMP, brenda 10 ditëve nga njoftimi i tij. Gjyba të derdhet në çdo bankë që ka llogari të Thesarit për Ministrinë e Mjedisit dhe Pyjeve. Me kalimin e afateve ligjore ekzekutimi i vendimit të dënimit me gjobë do të bëhet në mënyrë të detyrueshme, në zbatim të Ligjit Nr. 10297, datë 20.05.2010, "Për kundërvajtjet administrative".

Mora një kopje të vendimit, sot më datë

(I pa prurshëm.....)

Inspektori i ISHMP

Elmira Bica

Sed Hysa

Përpjesëtar

(Emër, mbiemër, firmë)

Në respektim të procedurave ligjore të përcaktuara në Proces-Verbalin për KKA, vendimi mbahet në katër kopje.



NJOFTIM

Nr. 5139/2, datë 9.7.2018

**PËR POZICIONIN E LIRË TË
SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM NË
KOMISIONIN E PAVARUR TË
KUALIFIKIMIT**

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton personat e interesuar të aplikojnë për pozicionin e Sekretarit të Përgjithshëm në këtë institucion.

10.7.2018

Në zbatim të nenit 20, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit shpall fillimin e procedurave për personat e interesuar që kërkojnë të aplikojnë për pozicionin e Sekretarit të Përgjithshëm në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit; kategoria e pagës: I-a.

Personat e interesuar të aplikojnë për këtë pozicion **brenda 20 ditëve pas publikimit**.

Të gjithë të interesuarit duhet të dorëzojnë në institucionin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (me postë apo dorazi) dokumentacionin sipas kriterëve të përcaktuara në pikën 3, të nenit 20, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si më poshtë vijon:

1. Kërkesë me shkrim, shprehje interesi.

2. Dokument që ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për Drejtësi ose në Shkenca Ekonomike me diplomë master i shkencave, në Shqipëri ose studimet universitare për Drejtësi, ose në shkenca ekonomike jashtë vendit dhe ka marrë një diplomë të njësuar sipas rregullave për njësimin e diplomave, të parashikuar me ligj.

Diplomën shoqëruar me listë notash, fotokopje të noterizuar.

Për personat që kanë përfunduar studimet jashtë vendit, dokumentin e njësimit të diplomës të shoqëruar edhe me diplomat dhe listën e notave përkatëse, fotokopje të noterizuar.

3. Dokument që ka pasur një përvojë pune në nivel menaxherial dhe drejtues jo më pak se 10 vjet.

CV të shoqëruar me librezë pune apo çdo dokument tjetër që vërteton këtë kriter.

(Njohuritë në nivel menaxherial përfshijnë: Njohuri në marrëdhënie pune, organizative,

drejtuese apo menaxheriale. Kandidati duhet të zotërojë në mënyrë të mjaftueshme aftësi profesionale dhe organizative për të përfaqësuar institucionin në marrëdhënie me palët e treta, si dhe të ketë aftësi personale për të mbajtur të motivuar dhe produktiv personelin e institucionit.)

Të plotësojë kriteret për pajisjen me certifikatë sigurie të nivelit të lartë.

4. Dokument që ndaj tij të mos ketë nisur një hetim penal, të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje.

Kandidati duhet të informojë, gjithashtu, për çështje të tjera të konfliktit të mundshëm të interesit apo të konfliktit në dukje. Ai duhet të shfaqë marrëdhënie mirëbesimi me Komitetin *ad hoc* gjatë procesit, i cili mban në konsideratë sjelljet e kandidatit në vlerësimin përfundimtar.

5. Dokument që zotëron shumë mirë gjuhën angleze. Njohuritë e gjuhës angleze do të testohen edhe nëpërmjet një interviste me gojë me kandidatin.

6. Dokument që ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit, në momentin e aplikimit.

Do të vlerësohet paraqitja e rekomandimeve pozitive të punës së tyre.

7. Dokument që nuk ka ushtruar funksione politike në administratën publike ose nuk ka mbajtur pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 viteve të fundit (kjo mund të shprehet edhe me deklaratë individuale).

NJOFTIM

Nr. 2023, datë 13.7.2018

**PËR SHPALLJEN E VENDEVE
VAKANTE PRANË INSTITUCIONIT TË
KOMISIONERIT PUBLIK**

Institucioni i Komisionerëve Publikë, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe vendimin e Kuvendit nr. 94/2017, “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Institucionit të Komisionerëve Publikë”, rishpall vendet vakante për pozicionet:

**Përkthyes (paga II-b)**

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijojnë:

a) Të zotërojë diplomë të nivelit master shkencor në gjuhë të huaja, dega Anglisht ose Drejtësi dhe të ketë minimumi 5 vjet eksperiencë në përkthim shqip–anglisht–shqip;

b) Të ketë njohuri shumë të mira në terminologjinë ligjore në të dyja gjuhët.

c) Kanë përparësi kandidatët me eksperiencë pune pranë organizatave ndërkombëtare.

Preferohen kandidaturat e licencuara përkthyes zyrtar nga Ministria e Drejtësisë.

Specialist protokoll/arkivi (IV-b)

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme, si vijojnë:

a) Të zotërojë diplomë të nivelit master shkencor;

b) Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze;

c) Të ketë të paktën 3 vite përvojë pune në profesion.

KUSHTE TË PËRGJITHSHME

Kandidatët duhet të sigurohen se plotësojnë kriteret për t'u pajisur me certifikatë sigurie, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 188, datë 4.3.2015.

Kandidatët duhet të kenë aftësi për t'u përshtatur e punuar në grup, nën presion, si dhe në afate kohore të limituara.

Të gjitha aplikimet duhet të dorëzohen në një nga format e dhëna më poshtë:

- Paraqitjes së kërkesës dorazi nga aplikanti, nga data 23 deri 27 korrik 2018, së bashku me dokumentet përkatëse, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, në adresën: bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 4, Tiranë, nga e hëna në të premte, ora 09:00–16:00;

- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, në adresën: bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 4, Tiranë. Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 27.7.2018 dhe të vërtetohet me fletëmandatin e lëshuar nga zyra postare.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant për të cilin është i interesuar. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon të

mbyllura në zarf 1 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

- Jetëshkrimin profesional përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare.

- Fotokopje të dokumentit të identifikimit (letërnjoftim, pasaportë, kartë identiteti);

- Dokumentet (diplomë, librezë pune, vërtetime, dëshmi, vetëdeklarim, certifikata, trajnime etj.) fotokopje ose të noterizuara. Diplomati që janë marrë jashtë vendit duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi;

- Dokument që vërteton se në ngarkim të tij nuk është regjistruar një procedim penal (vërtetim nga Gjykata, vërtetim nga Prokuroria, dëshmi e gjendjes gjyqësore);

- Vërtetim nga institucioni ku punon që nuk ka masë disiplinore në fuqi;

- Një rekomandim nga punëdhënësi;

- Raport që vërteton se është në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;

- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme.

Kandidatët që plotësojnë kriteret formale dhe kanë depozituar dokumente të fotokopjuara, përpara intervistës i parashtrojnë Komitetit *Ad-Hoc* dokumentet e njësuara ose ato origjinale.

NJOFTIM

Nr. 554, datë 13.7.2018

**PËR SHITJE ME ANKAND TË PRONËS
SHTETËRORE NË ADMINISTRIM TË
MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE**

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Pronës Publike, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014, “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes”, të ndryshuar, kapitulli III, pika 16, shpall për shitje me VAM fillestar, si më poshtë:



Në administrim të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale:

Nr.	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit (mjete kryesore + truall)	Mjetet kryesore	Trualli			Data	Ora	Vendi
1	Ish-Qendra Ekonomike e Drejtorisë së Shërbimit Publik	Gjirokastrë	1 546 011.45	1 359 925.2	186 086.25	38.25	38.25	26.7.2018	14:00	DDPP

Çdo person fizik apo juridik i interesuar për blerje me ankand duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit, dokumentacionin si më poshtë:

1. Kërkesë me shkrim për blerjen e objektit apo të ndërmarrjes, të regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. Mandatpagesën apo garancinë bankare në origjinal që vërteton derdhjen apo ngurtësimin e 20% të vlerës së fillimit të ankandit, në lekë për llogari të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

3. Dokument identifikimi (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

Shënim. Pjesëmarrësit në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi, pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e objektit të shpallur për shitje, nuk i kthehet 20% e vlerës fillestare, të ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

Subjekti i shpronësuar i truallit mbi të cilin ndodhet objekti apo ndërmarrja duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit, dokumentacionin si më poshtë:

1. Kërkesë me shkrim për blerjen e objektit apo të ndërmarrjes, të regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. Mandatpagesën apo garancinë bankare që vërteton ngurtësimin e 20 për qind të vlerës fillestare në lekë, vetëm për objektin (mjete kryesore), për llogari të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, detyrimsht brenda afatit të pranimit të kërkesave.

3. Vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, të shoqëruar me planvendosjen e pronës, ku përcaktohet se ai është subjekt pronar i tokës.

4. Dëshminë e trashëgimisë, prokurë përfaqësimi etj. nëse ka të tilla.

5. Deklaratë noteriale, në të cilën trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar që kërkojnë të ushtrojnë të drejtën e parablerjes për objektin në proces privatizimi, të deklarojnë, se që nga momenti që janë pajisur me vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, nuk kanë përfutur kompensim në asnjë nga format e parashikuara në ligj. Gjithashtu, të deklarojnë se vendimi i ish-Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ose i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave nuk ka ndryshuar ose është shfuqizuar me ndonjë akt administrativ apo vendim të formës së prerë.

Mandatpagesa apo garancia bankare duhet të bëhet detyrimsht brenda afatit të pranimit të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Mandatpagesa apo garancia bankare mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, pasi të keni tërhequr pranë DDPP-së ose degëve të thesarit në rrethe, faturën për arkëtim të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Këto informacione gjenden edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Financave: www.financa.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.